



## Raporti mujor mbi ndjekjen e Kapitullit 23 – gjyqësori, lufta kundër korrupsionit dhe të drejtat themelore – mars 2017

### I GJYQËSORI

#### 1. Pavarësia

##### Dorëheqja e kryetares u.d. së Gjykatës Themelore Shkup 1, Tatjana Mihajlova

Gjykatësja Tatjana Mihajlova, e cila ka kryer funksionin e ushtruesit të detyrës kryetare e Gjykatës Themelore Shkup 1 më 07.03.2017, me shkresë me shkrim e ka informuar Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë se jep dorëheqje të pakthyeshme nga funksioni.<sup>1</sup> Veprimi i tillën vijon pasi shumica e gjykatësve dorëzuan ankesë në Gjykatën e Lartë në lidhje me orarin vjetor të cilin e përgatiti gjykatësja Mihajlova, me të cilin ata pa u konsultuar janë transferuar në vende të reja pune. Një pjesë e atyre gjykatësve ishin ata pak gjykatës të cilët vendosën pozitivisht për kërkesat e PSP-së. Para pak kohësh shtatë prej tetë gjykatësve, Gjykata e Lartë ua pranoi ankesat dhe i ktheu në vendet e tyre të mëparshme të punës. Më 14.03.2017 Gjykata Themelore Shkup 1 informoi<sup>2</sup> se është bërë dorëzimi i funksionit u.d. Kryetar i gjykatës nga gjykatësja Tatjana Mihajlova për gjykatësin Stojançe Ribarev që vjen nga Gjykata e Lartë ku është zgjedhur si gjykatës në shtator të vitit 2016.

##### Jovo Vangelovski, kryetari i ri, përkatësisht, i vjetër i Gjykatës së Lartë

Jovo Vangelovski është zgjedhur si Kryetar i Gjykatës së Lartë. Në seancën e jashtëzakonshme të Këshillit Gjyqësor për të kanë votuar 12 anëtarë të Këshillit, kurse një ka qenë kundër. Vendimi për emërimin e tij është miratuar në seancën 248 të Këshillit Gjyqësor.<sup>3</sup> Në seancë është konstatuar përfundimi i detyrës së ish u.d. kryetares së Gjykatës Themelore Shkup 1. Vangelovski ishte kandidat për këtë funksion së bashku me gjykatësen e Gjykatës së Lartë Lidija Nedellkova, u.d. kryetaren e Gjykatës së Lartë Snezhana Bajlozova dhe gjykatësen Besa Ademi. Vangelovski ka qenë kryetar para katër vjetësh dhe pas mandatit të parë nuk u kandidua përsëri. Një pjesë e publikut dhe mediat nuk janë dakord me përzgjedhjen e tillë, duke pasur parasysh se në një prej bisedave telefonike të përgjuara dhe të shpallura nga opozita, gjykatësi Vangelovski bisedon për kompletimin e listave gjyqësore me ish-ministrin e transportit dhe lidhje, në lidhje me lëndën “Global” ky i dyshuari i parë është lideri i LSDM-së, Zoran Zaev.

<sup>1</sup> <http://www.ssrn.mk/Novosti.aspx?novost=498>

<sup>2</sup> <http://www.osskopje1.mk/Novosti.aspx?novost=595>

<sup>3</sup> <http://www.ssrn.mk/Novosti.aspx?novost=500>





## Orari kontrovers vjetor i gjykatësve në Gjykatën Themelore Shkup 1

Kryetari i ri i emëruar në Gjykatën Themelore Shkup 1, Stojançe Ribarev, më 28.03.2017 u dorëzoi gjykatësve Orarin e ri vjetor për punë për vitin 2017. Në lajmërimin e Gjykatës thuhet se gjatë përpunimit të rendit është marrë parasysh gjendja me lëvizjen e lëndëve nga të gjitha fushat, prapambetja në disa fusha të caktuara dhe nevoja për urgjencë në veprim për disa lloje të lëndëve e përcaktuar në afatet ligjore, si dhe shënimet për punën e gjykatësve nga instancat më të larta.<sup>4</sup> Orari vjetor i kryetarit Ribarev, i cili në funksion ka ardhur vetëm dy javë para dorëzimit të orarit, është pritur me reagime të furishme nga publiku. Reagimet lidhen me vendosjen e ish-kryetarit Vlladimir Pançevskit dhe gjykatëseve Elena Josifoviq, Aleksandra Pop Stefanija dhe Lidija Petrovska në Njësinë për krim të organizuar, si gjykatëse në procedurë të mëparshme, ku do të veprojnë për lëndë të PSP-së. Josifoviq dhe Pop Stefanija janë përmendur në raportin e Stejt Departmenit për vitin 2016 për relacionet e tyre të afërta partiake dhe afariste me partinë e atëhershme në pushtet VMRO DPMNE dhe përvojën e vogël pesëvjeçare si gjykatëse. Pançevski do të udhëheqë Këshillin Penal, trup para të cilit PSP-ja dorëzon ankesa pas kërkesave të refuzuara në procedurën e mëparshme. Në këtë këshill futet dhe Lidija Petrovska, zëri i të cilës dëgjohej edhe në bisedat e përgjuara.

## Prokurori publik shtetëror me kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në rastin “Trust”

Më 27 mars, Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë në Gjykatën e Lartë ka dorëzuar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në lidhje me arrestin e biznesmenit Sead Kočan, i dyshuar në rastin “Trust”, nën kompetencë të PSP-së. Prokuroria Publike ka kërkuar nga Gjykata e Lartë ta pranojë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, t’i anulojë vendimet e Gjykatës Themelore Shkup 1 të 7 marsit 2017 dhe të Gjykatës së Apelit më 15 mars 2017 dhe lëndën ta kthejë për rigjykim dhe rivendim. Në kërkesë, prokuroria shtetërore e sulmon vendimin e Këshillit Penal në Gjykatën Themelore Shkup 1 ku thuhet se ankesa nuk e pengon zbatimin e vendimit, përkatësisht është shkelur veprimi suspendues ankesës. Me ndërmarrjen e veprimeve për zbatim të vendimit para se të hyjë në fuqi, nga Prokuroria Publike thonë se Këshilli ka kryer shkelje të nenit 134, paragrafi 5 i Ligjit për Procedurë Penale. Veprimi pozitiv në lidhje me këtë kërkesë do të thotë marrje e kompetencës së PSP-së që të dorëzojë mjete juridike të jashtëzakonshme dhe ndërprerje e paraburgimit për z. Kočan.

Ka vijuar reagim i shpejtë i PSP-së. Prokurorja publike Katica Janeva me shkresë te Gjykata e Lartë e tërhoqi kërkesën.<sup>5</sup> Ajo në një arsyetim të shkurtër theksoi se si Prokuror Special Publik vetëm ajo është kompetente të veprojë sipas lëndëve që lidhe dhe dalin nga përmbajtja e ndjekjes së paligjshme të komunikimeve në të gjitha instancat e gjyqësore, duke iu drejtuar nenit 5, zërit 3 të Ligjit për PSP-në ku

<sup>4</sup> <http://www.osskopje1.mk/Novosti.aspx?novost=598>

<sup>5</sup> <http://www.jonsk.mk/wp-content/uploads/2017/03/2017-03-29-%D0%BD%D1%81%D0%BA-%D0%BA%D0%BE-4-17-%D0%BF%D0%BE%D0%B2%D0%BB%D0%B5%D0%BA%D1%83%D0%B2%D0%B0%D1%9A%D0%B5-%D0%BD%D0%B0-%D0%B1%D0%B0%D1%80%D0%B0%D1%9A%D0%B5-%D0%B7%D0%B0-%D0%B1%D0%B7%D0%B7-%D0%B4%D0%BE-%D0%B2%D1%80%D1%85%D0%BE%D0%B2%D0%B5%D0%BD.pdf>





thuhet se Prokurori Publik i cili udhëheq PSP-në është i autorizuar të ndërmarrë veprime dhe të përfaqësojë lëndët para gjykatave themelore, të apelit dhe Gjykatës së Lartë të Republikës së Maqedonisë. Paragrafi 4 i nenit 5 i Ligjit edhe më konkretisht e përcakton kompetencën e jashtëzakonshme të Janevës në ndërmarrjen e veprimeve të prokurorisë, ku thuhet se Prokurori publik i cili udhëheq PSP-në ka kompetencë dhe autorizim të tërësishëm t'i zbatojë në mënyrë të pavarur të gjitha funksionet hetimore dhe prokurorike të Prokurorisë Publike, të cilat përfshijnë pjesëmarrje në procedurat gjyqësore dhe fillim të cilësdo procedurë gjyqësore, duke përfshirë edhe procedurën qytetare dhe penale, të cilat prokurori publik i konsideron si të nevojshme.

Pasi kryetari i Gjykatës së Lartë, Jovo Vangellovski, pohoi se megjithatë do të veprojë sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë së prokurorisë së Marko Zverlevskit, PSP-ja kërkoj tërheqjen e Vangellovskit pas marrjes së vendimit për kërkesën që të hiqet paraburgimi për Sead Kočan. PSP-ja dyshon në paanësinë e tij për shkak të bisedës midis tij dhe ish-ministrit të transportit dhe lidhjeve, Mile Janakievski në lidhje me rastin "Global", kur ai ka qenë kryetar i Gjykatës së Lartë në mandatin e parë.<sup>6</sup>

### **AOGJSH-së dhe SHAS kërkojnë dorëheqjen e kryetarit të Këshillit Gjyqësor**

Sindikata e Punëtorëve të Administratës, Organeve Gjyqësore dhe Shoqatave të Qytetarëve në Republikën e Maqedonisë (AODGJSH) dhe Shoqata e Administratës Gjyqësore (SHAGJ) kërkuar dorëheqje të Zoran Karaxhoskit, kryetarit të Këshillit Gjyqësor sepse Këshilli dhe Ministria e Drejtësisë nuk e njohin kërkesën e vetme gjatë grevës në vitin 2016 që ka zgjatur 62 ditë, të punësuarit në gjykatë t'i marrin shtesat në rrogë. Shoqata i rekomandoi Karaxhoskit që të mos i provokojë të punësuarit dhe në vend që t'u presë 40% të rrogës për grevën të japë dorëheqje me të cilën do të lehtësohet zgjidhja e problemit të grevistëve.

## **2. Paanësia**

### **U përcaktua masa paraburgim për një person të dyshuar me propozim të PSP-së**

Prokuroria Speciale Publike (PSP) ka dorëzuar propozime për përcaktim të masës paraburgim për dy persona të dyshuar në lëndën "Trust". Pas shqyrtimit të propozimit gjykatësi në procedurë të mëparshme e hodhi poshtë propozimin për përcaktim të masës paraburgim për biznesmenin Sead Kočan.<sup>7</sup> PSP-ja para gjykatësit në procedurën e mëparshme e tërhoqi propozimin për paraburgim të personit Vasilie Aviroviq dhe propozoi masa të kujdesit – Ndalim i vendosjes, përkatësisht mbajtjes së kontakteve ose lidhjeve me personat të përcaktuar dhe masa - Ndalim për kryerjen e aktiviteteve të caktuara të punës të cilat lidhen me këtë vepër penale. Ky propozime është miratuar.

<sup>6</sup> <http://www.jonsk.mk/wp-content/uploads/2017/03/2017-03-29-%D0%BD%D1%81%D0%BA-%D0%BA%D0%BE-4-17-%D0%B1%D0%B0%D1%80%D0%B0%D1%9A%D0%B5-%D0%B7%D0%B0-%D0%B8%D0%B7%D0%B7%D0%B5%D0%BC%D0%B0%D1%9A%D0%B5-%D0%B4%D0%BE-%D0%92%D1%80%D1%85%D0%BE%D0%B2%D0%B5%D0%BD-%D1%81%D1%83%D0%B4.pdf>

<sup>7</sup> <http://www.oskopje1.mk/Novosti.aspx?novost=594>





PSP-ja u ankua për vendimin me të cilin është refuzuar propozimi për paraburgim të Koçanit para Këshillit Penal në Gjykatën Themelore. Këshilli e pranoi ankesën në tërësi dhe kështu u përcaktua masa e dytë paraburgim në lëndë të Prokurorisë Speciale Publike. Sead Koçani është iku arrati 2 ditë para marrjes së vendimit nga ky Këshill dhe për të është lëshuar urdhër arresti ndërkombëtar. Ndërkohë mbrojtësi i z. Koçan ka dorëzuar ankesë në Gjykatën e Apelit e cila e ka pranuar pjesërisht ankesën. Sipas vendimit,<sup>8</sup> Këshilli Penal në Gjykatën Themelore Shkup 1 ka vlerësuar si duhet se ekziston rrezik prej arratisë. Njëkohësisht këshilli prej tre gjykatës të Gjykatës së Apelit kanë vendosur se nuk ekzistojnë rrethanat për ndikim mbi dëshmitarët dhe përsëritjen e veprës penale. Me këtë vendim hapet mundësia që i dyshuari të japë garanci dhe të mbrohet në liri.

### **Prokuroria Publike e RM-së hap procedura të reja për parregullsitë në zgjedhje**

PPRM-ja shpalli se do të hapë dy procedura të reja hetimore për parregullsitë zgjedhore për zgjedhjet për President në vitin 2014 dhe Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të mbajtura në dhjetor të vitit 2016.<sup>9</sup> Në procedurat hetimore janë përfshirë më tepër persona, midis të cilëve edhe ish-përfaqësues të lartë të MPB-së, të pushtetit lokal dhe mbartës të funksioneve të larta në një parti të caktuar politike. Personat janë të dyshuar për vepra të ndryshme lidhur me zgjedhjet. Në shkurt të vitit 2017 Prokuroria Publike Themelore për Ndjekje të Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit shpalli se po kryejnë procedura parahetimore për shkak të ekzistimit të bazave të dyshimit për vepra kriminale të kryera në mënyrë të organizuar kundër zgjedhjeve dhe keqpërdorime të autorizimeve zyrtare në kryerjen e funksionit nga ish-funksionarë të lartë të MPB-së dhe nga persona të tjerë fizikë dhe juridikë nga Shkupi, Kumanova dhe Strumica.<sup>10</sup> Ekziston mundësia procedurat e reja hetimore të hapura të jenë pikërisht vazhdim i këtyre veprimeve parahetimore. Që në shpalljen e lajmit për procedurat parahetimore, veprimi i tillë nga PTHP-ja te një pjesë e opinionit janë vlerësuar si seleksionuese dhe kundërpeshë e hetimeve për parregullsitë zgjedhore që i ka hapur PSP-ja kundër ish-funksionarëve të lartë qeveritarë, gjithashtu, për mashtrime zgjedhore.

### **U hap procedura hetimore për një funksionar të lartë nga Komuna e Strumicës**

Prokuroria Publike për Ndjekje të Krimit dhe Korrupsionit të Organizuar shpalli se ka dhënë Urdhër për zbatim të procedurës hetimore kundër një personi zyrtar mbartës i një funksioni të lartë në Komunën e Strumicës, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer vepër penale Keqpërdorim i pozitës dhe autorizimit zyrtar.<sup>11</sup> Sipas kësaj Prokurorie, i dyshuari në vitin 2010 me të njëjtin person juridik nga Strumica ka bërë katër marrëveshje të veçanta me vlerë të përgjithshme mbi një milion denarë për asfaltim të të njëjtës rrugë në një vendbanim në Komunën e Strumicës. Sipas informacioneve joformale në disa media bëhet fjalë për vazhdim të veprimeve parahetimore lidhur me punën e Komunës të cilat

<sup>8</sup><http://www.asskopje.mk/Novosti.aspx?novost=33>

<sup>9</sup><http://jorm.gov.mk/?p=3913>

<sup>10</sup><http://jorm.gov.mk/?p=3872>

<sup>11</sup><http://jorm.gov.mk/?p=3901>





Prokuroria i ka zbatuar gjatë vitit 2016 kur ka hyrë në hapësirat e Komunës dhe në kabinetin e kryetarit të atëhershëm të komunës dhe liderin aktual të LSDM-së, Zoran Zaev, prej nga kanë marrë kompjuterë, kurse janë marrë në pyetje edhe rreth dhjetë të punësuar.

### 3. Kompetenca

#### PSP-ja e dorëzoi raportin e tretë gjashtëmuor.

Më 15.03.2017 CJO shpalli se te Këshilli i Prokurorëve dhe në Kuvendin e RM-së ka dorëzuar raportin e tretë gjashtëmuor.<sup>12</sup> Sipas raportit, deri më 15 mars 2017, PSP-ja ka kryer procedura parahetimore kundër 112 personave, kurse 50 persona janë lëndë e procedurave parahetimore. Tani ekipi i Prokurorisë është 117 persona, duke përfshirë edhe ekipin hetimor dhe të prokurorisë. Është analizuar përmbajtja e 272.950 audiofajleve përkatësisht është përpunuar 45% e numrit të përgjithshëm të audiofajleve të cilat i posedon PSP-ja.

#### Filloi trajnimi i gjeneratës së tretë të dëgjuesve në Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë

Akademi shpalli se për 37 dëgjuesit ka filluar trajnimi 24-mujor fillestar ku në mënyrë profesionale dhe eksperte do të përkryhen për profesionin gjyqësor dhe prokuror-publik.<sup>13</sup> Në ceremoni mbajtën fjalim drejtoresha e Akademisë, Aneta Arnaudovska, kryetari i Këshillit Gjyqësor, Zoran Karaxhoski, ushtruesja e atëhershme e detyrës së kryetares së Gjykatës së Lartë, Snezhana Bajlozova, Prokurori shtetëror publik, Marko Zverlevski dhe kryetari i Këshillit të Prokurorëve Publikë, Petar Anevski. Folësit u uruan suksese në trajnime dëgjuesve dhe theksuan se vetëdija, nderi dhe paanësia janë karakteristikat kryesore të cilat duhet t'i posedojë secili që të mund të ballafaqohet me përgjegjësitë që dalin nga profesioni i tyre.

#### Lëndë më të rëndësishme gjyqësore

##### “Komuna Qendër”

Seanca e shqyrtimit më 10.03.2017 për lëndën në të cilën si i akuzuar është z. Nikolla Gruevski së bashku me 15 bashkëpunëtorë e vet për veprën penale “Dhunë” sipas neni 386 zëri 1 në lidhje me zërin 1 të KP-së është shtyrë menjëherë për shkak të mungesës së kushteve për mbajtjen e saj, për shkak të mungesës së të akuzuarve. Seanca e ardhshme është caktuar më 03.05.2017.

##### “Zoran Bozhinovski”

Më 06.03.2017 dhe më 31.03.2017 janë mbajtur seanca për gjykimin e lëndës KOK-79/16, ku si i akuzuar për veprat penale “Shoqërim kriminal” dhe “Spiunim” është gazetari Zoran Bozhinovski. Seanca më

<sup>12</sup> <http://www.jonsk.mk/2017/03/15/доставен-третиот-шестмесечен-извешт/>

<sup>13</sup> <http://www.jpacademy.gov.mk/novosti/aae----6----->







06.03.2017 është shtyrë për shkak të mungesës së dëshmitarit për të cilin mbrojtja kërkoi nga gjykata që të mundësojë lidhje konference për dëgjim. Para fillimit të seancës së ardhshme, Gjykata i informoi të pranishmit se nuk është marrë ende ndonjë informacion për qasjen te dëshmitari/i dëmtuari, prandaj u dëgjuan dy dëshmitarë të tjerë. Për shkak të mënyrës së marrjes në pyetje të dëshmitarëve në këtë seancë në raport me seancat e mëparshme mbetet e paqartë çështja e mban gjykata këtë lëndë sipas Ligjit të ri për procedurë penale apo atij të vjetër. Seanca e ardhshme për këtë gjykim është caktuar më 26.04.2017.

### **“Lagjja e trimave”**

Seancat për lëndën KOK nr. 127/15 gjatë këtij muaji ishin të hapura për publikun dhe në të merreshin në pyetje dhe dëgjoheshin të akuzuarit. Janë dëgjuar dy prej të akuzuarve mbi faktet dhe rrethanat të cilat lidhen me kohën dhe vendin kur supozohet se është kryer vepra penale. Procedura gjyqësore në këtë lëndë vijon në përputhje me Ligjin për Procedurë Penale dhe pa shkelje të tyre. Të akuzuarit gjykohen për veprat penale “Terrorizëm” dhe “Organizatë terroriste”. Seancat e ardhshme janë caktuar për më 19, 21, 25 dhe 27 prill.

### **“Erazmus”**

Gjykimi për rastin “Erazmus” është mbajtur më 15.03.2017. Janë akuzuar gjashtë profesorë dhe demonstratorë të Fakultetit Ekonomik në Shkup, për veprat penale “Marrje mito”, “Marrje shpërblim për ndikim të paligjshëm”, “Keqpërdorim të pozitës dhe autorizimeve zyrtare” dhe “Dhënie mito”. Gjykata filloi me seancën kryesore përkatësisht fjalimet hyrëse, por për shkak të sigurimit të dëshmitarëve seanca u shty për më 18.04.2017.

### **“Rover”**

Gjykimi për rastin “Rover” i regjistruar me numrin K. nr.2454/15 është mbajtur më 24.03.2017. Në këtë lëndë ka katër të akuzuar, midis të cilëve edhe kryetari i partisë politike Të Bashkuar për Maqedoninë dhe ish-ministri i punëve të brendshme, të cilët akuzohen për vepër penale të kryer – Vrasje, Kodi Penal. Në seancë mungonin i akuzuari, mbrojtësi dhe dëshmitarët. Për këtë arsye seanca gjyqësore është shtyrë për më 26.05.2017.

### **“Kështjella 2”**

Më 13.03.2017 u mbajt seanca e lëndës “Kështjella 2”, nën kompetencë të PSP-së. Në këtë lëndë shtatë persona janë të dyshuar se kanë shkatërruar 2.047 shkresa zyrtare, prej të cilave 22 lidhen me sistemet për ndjekjen e komunikacioneve. PSP-ja mori dy vendime për deklasifikim të pjesës më të madhe të dëshmive në këtë lëndë dhe theksoi se kanë mbetur vetëm librat e klasifikuara të protokollit dhe se përgjigjen për deklasifikim e kanë marrë nga ministri i punëve të brendshme. Sipas PSP-së bashkëpunimi me DSK-në edhe mandej është i vështirë, sidomos për shkak të refuzimit të pranimit të postës nga PSP-





ja, prandaj përgjigjet e kërkesave të tyre i kanë marrë nga ministri. Në këtë seancë u shfaq vetëm një avokat nga ekipi i avokatëve të mbrojtjes, prandaj për shkak të mungesës së kushteve për mbajtjes së seancës, ajo është shtyrë të mbahet më 05.05.2017.

## II LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

### Katër hetime të reja të PSP-së

PSP-ja në konferencën për shtyp<sup>14</sup> më 23.03.2017 shpalli hapjen e katër hetimeve të reja financiare, të cilat janë në fazën e dyshimit të bazuar.

1. **TABELA** – Keqpërdorimi i pozitës zyrtare të drejtorit të shkollës fillore në fshatin Zajas dhe vendimi i tij që të ndërtohet shkollë e re fillore pa respektim të dispozitave ligjore. Në këtë rast bëhet fjalë për dëm prej rreth 200 mijë eurosh, saç ka qenë edhe marrëveshja e nënshkruar pa furnizim publik, për ndërtim të shkollës në fshatin Strogovishtë.
2. **TREQIND** – I dyshuar është ndihmës-ministri i MPB-së për furnizimin publik të zbatuar për 300 automjete për Ministrinë. I dyshuari në periudhën 2008 deri në 2012 kanë kryer furnizim të 300 automjete pa i respektuar dispozitat ligjore për furnizim publik, duke dëmtuar kështu buxheti i shtetit me 453.570 euro.
3. **TOTAL** – Evasion fiskal është vepër penale e vazhduar për të cilën ka dyshime të bazuara në këtë rast, ku i dyshuar është një person. Pronari i disa kompanive për marketing dhe shërbime konsultuese, Total. Media Mak, Total Marketing, Media centar, në periudhën nga viti 2008 deri në vitin 2015 ka shmangur pagimin e tatimit në vlerë prej 180 mijë eurosh.
4. **TIFANI** – Përsëri bëhet fjalë për evazion fiskal, kurse e dyshuar është pronarja e firmave për marketing dhe shërbime konsultuese Smart centar dhe Smart grup. Edhe në këtë rast ekziston dyshimi i bazuar se në periudhën prej vitit 2008 deri në vitin 2014 kompanitë dhe pronarja kanë shmangur pjesërisht pagimin e tatimeve duke dhënë të dhëna të rrema për obligimet.

### Fjalimi i Katica Janevës në Ditën Ndërkombëtare të Informatorëve

Prokurorja speciale publike, Katica Janeva mbajti fjalim në shënimin e ditës së informatorëve.<sup>15</sup> Ajo rikujtoi nevojën e zbatimit të rekomandimeve të Komisionit të Venecias në lidhje me Ligjin për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Ligjin për Mbrojtjen e Informatorëve, për shkak të problemeve me të cilat ballafaqohet vazhdimisht PSP-ja në punën e saj. Janeva shprehu mirëkuptim për bashkëpunimin e

<sup>14</sup> <http://www.jonsk.mk/2017/03/23/%D0%B8%D0%B7%D1%98%D0%B0%D0%B2%D0%B0-%D0%BE%D0%B4-%D0%BF%D1%80%D0%B5%D1%81-%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D1%84%D0%B5%D1%80%D0%B5%D0%BD%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0-3/>

<sup>15</sup> <http://www.jonsk.mk/2017/03/24/катица-јанева-со-свое-излагање-на-меѓу/>





vështirë me qytetarët në procedurat të cilat i kryejnë për shkak të frikës së pranishme për pasojat dhe reperkusionet të cilat këta qytetarë mund t'i kenë mbi veten dhe më të afërmit e tyre. Prokurorja shprehu besimin te qytetarët për të cilët thotë se posedojnë guxim të dalin dhe të ndihmojnë në këtë proces edhe pse janë të vetëdijshëm për rrezikun i cili ekziston.

## IV TË DREJTAT THEMELORE

### 1. Sundimi i të drejtës

Siç është thënë në brif-monitorimin e mëparshëm për muajin shkurt: “Më 28 shkurt 2017, gjatë tubimit të qytetarëve “Për Maqedoni të përbashkët” është sulmuar një pjesë e ekipit të gazetarëve të medias elektronike A1ON (<http://a1on.mk/>). Një gazetar dhe një xhirues janë goditur me “grushte në kokë dhe në trup, kurse një pjesë e demonstruesve e kanë thyer kamerën. Meqenëse organizatori i protestës nuk ka arritur t'i mbrojë nëpunësit e mediave, nga A1ON paralajmëruan se do të ngrenë fletëparaqitje kundër iniciativës “Për Maqedoni të përbashkët” dhe do të kërkojë kompensim për dëmin për “sjelljen e egër dhe primitive.”<sup>16</sup> Gjatë marsit nga MPB-ja te Prokuroria Themelore Publike është dorëzuar fletëparaqitje penale kundër M.K. (37) nga Shkupi, për shkak të dyshimit se së bashku me një person tjetër të panjohur deri tani ka marrë pjesë në sulm. Nga MPB-ja shtojnë se “Pas mbikëqyrjes së kryer të video-materialit të kamerave të sigurisë të QTQ-së Shkup është kryer krahasim me pamjen e shpallur më parë në portalin në internet “www.sdk.mk”, me fotografi nga evidenca e MPB-së së RM është vërtetuar se bëhet fjalë për M.K. nga Shkupi, kryerës i njohur i delikteve të pronës dhe prishës i rendit dhe qetësisë publike.”<sup>17</sup> Ministri i punëve të brendshme, Agim Nuhiu, nga Klubi i gazetarëve, me këtë rast theksoi se “askush nuk është mbi ligjin” dhe se “secili, një ditë do të mbajë përgjegjësi”, duke dhënë mbështetje për mediat dhe duke theksuar se nga MPB-ja do të ndërmerren të gjitha masat për “zbardhjen si të këtij rasti ashtu edhe të të gjitha rasteve të tjera në të cilat të dëmtuar janë përfaqësuesit e mediave.”<sup>18</sup>

### 2. Liria e shprehjes dhe pluralizmit në media – sulme mbi gazetarët

Në mars është sulmuar edhe gazetari Hristijan Banevski i televizionit “24 Vesti”, ndërkohë që ka informuar për ngjarjen kur një demonstrues ka gjuajtur me flamur drejt tij dhe e ka goditur në kokë. Sulmi është dënuar nga profesionistët maqedonas, por edhe nga gazetarët nga rajoni,<sup>19</sup> nga Agjencia për Shërbime Audio dhe Audio-vizuale të Mediave (ASHVM) është theksuar se: “Sulmi mbi profesionistët e

<sup>16</sup> <http://a1on.mk/archives/709516>

<sup>17</sup> <http://www.mvr.gov.mk/vest/3724>

<sup>18</sup> <http://www.mvr.gov.mk/vest/3725>

<sup>19</sup> [http://24vesti.com.mk/reakcii-za-napadot-na-ekipata-na-tv24?quicktabs\\_popularna\\_sodrzina=1](http://24vesti.com.mk/reakcii-za-napadot-na-ekipata-na-tv24?quicktabs_popularna_sodrzina=1)







mediave është sulm i drejtpërdrejtë mbi demokracinë dhe lirinë e fjalës në një shoqëri”,<sup>20</sup> kurse Këshilli i Etikës në Mediat në Maqedoni rikujtoi obligimin e shtetit “që të ndërmarrë të gjitha masat aktive për krijimin dhe mirëmbajtjen e mjedisit të përshtatshëm për lirinë e shprehjes në përputhje me nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”<sup>21</sup> KEMM-i në analizën e tyre vjetore për ndryshime në rregullativë dhe vetërregullim të mediave në Maqedoni për vitin 2016 e theksuan krijimin e mjedisit të sigurt për punë të lirë të gazetarëve dhe përfaqësuesve të mediave si një nga mesazhet kryesore.

Verbalisht është sulmuar edhe ekipi i gazetarëve të televizionit “Telma” në përpjekje të transmetojë qëndrime nga një pjesë e të pranishmëve në tubimet e iniciativave “Për Maqedoni të përbashkët”. Kryetari i Shoqatës së Mediave, Naser Selmani, deklaroi: “Është për të ardhur keq që dhuna mbi gazetarët është e koordinuar nga qendrat politike të fuqisë (...) Dhuna pa mëdyshje kundër gazetarëve lidhet me pastrimin e llogarisë së nxehtë politike i cili po ndodh në Maqedoni.”<sup>22</sup> Siç informojnë nga njëri prej televizioneve të sulmuara, “Telma”, nga organizatorët e tubimeve “Për Maqedoni të përbashkët” nuk ndjejnë përgjegjësi sepse nuk kanë pasur mundësi të kontrollojnë një turmë kaq të madhe.

Gjatë këtij muaji është sulmuar edhe gazetari Borjan Jovanovski, i cili gjatë drekës në restorant është poshtëruar dhe nënvlerësuar publikisht pasi një person i panjohur i është drejtuar me “Tradhtar” dhe e ka pështyrë,<sup>23</sup> ndërsa kjo është xhiruar, kurse pastaj xhirimi është shpallur. ASHVM-ja e ka dënuar këtë ngjarje, dhe ka theksuar se “Për mendime dhe qëndrime të ndryshme në një shoqëri demokratike duhet të bisedohet me argumente, kurse roli i mediave dhe gazetarëve në atë proces është me rëndësi të theksuar.”<sup>24</sup>

### 3. Të drejtat e fëmijëve

Gjatë këtij muaji, në zyrën e Avokatit të Popullit janë dorëzuar ankesa nga prindër të cilët ankohen për keqpërdorim të fëmijëve të tyre në protesta dhe tubimet aktuale të iniciativës “Për Maqedoni të përbashkët”. Sipas Avokatit të Popullit, në këtë keqpërdorim janë përfshirë dhe janë nxitur drejtpërdrejt edhe disa persona, të punësuar në institucionet arsimore. Në lidhje me këtë, Avokati i Popullit, Ixhet Memeti, deklaroi: “Fëmijët në asnjë rast nuk duhet të jenë pjesë e manipulimeve dhe keqpërdorimeve, kurse shkollat duhet të jenë vendet ku duhet të kryhet veprimtaria themelore procesi arsimor-edukativ. Si rrjedhim, Avokati i Popullit duke u udhëhequr nga interesi më i mirë i fëmijëve apelon edhe te arsimtarët edhe te prindërit të mos lejojnë në asnjë mënyrë përfshirjen e nxënësve në çfarëdo lloj

<sup>20</sup> [http://www.avmu.mk/index.php?option=com\\_content&view=article&id=3178%3A-24-&catid=88%3Asoopstenija-media&Itemid=313&lang=m](http://www.avmu.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=3178%3A-24-&catid=88%3Asoopstenija-media&Itemid=313&lang=m)

<sup>21</sup> <http://a1on.mk/archives/713873>

<sup>22</sup> <http://www.telma.com.mk/vesti/pcosti-i-verbalni-napadi-vrz-novinarite-na-telma>

<sup>23</sup> <https://www.facebook.com/borjan.ez/posts/10158210470150109>

<sup>24</sup> [http://www.avmu.mk/index.php?option=com\\_content&view=article&id=3168%3A2017-03-03-12-07-12&catid=88%3Asoopstenija-media&Itemid=313&lang=mk](http://www.avmu.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=3168%3A2017-03-03-12-07-12&catid=88%3Asoopstenija-media&Itemid=313&lang=mk)





tubimesh dhe protestash, kurse njëkohësisht u bëjnë thirrje institucioneve kompetente që të reagojnë menjëherë në pengimin e dukurive të tilla.<sup>25</sup>

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë ka reaguar kundër keqpërdorimit politik të të miturve, pasi regjistroi dy raste ku nxënësit e shkollave të mesme u bëhet thirrje për në protestë, kurse qëllimi është demok mbrojtja e interesave shtetërore dhe nacionale.

Nga Komiteti, sidomos në lidhje me rastin e shkollës së mesme “Mirçe Acev” nga Prilepi, kur drejtori i shkollës, mbajti fjalim politik dhe i nxiti nxënësit në protestë demok për mbrojtjen e gjuhës maqedonase dhe unitetit të shtetit, përcaktuan tejkalim të autorizimeve zyrtare dhe shkeljes së Ligjit për Arsimin e Mesëm. Prandaj, Komiteti dorëzoi ankesa tek Inspektorati Arsimor Shtetëror dhe Avokati i Popullit, me qëllim që të përcaktojnë veprimin e jashtëligjshëm të drejtorit të shkollës së mesme “Mirçe Acev” nga Prilepi dhe të inicijonë procedurat përkatëse për sanksionimin e tij.<sup>26</sup>

Në lidhje me këto raste, Avokati i Popullit reagoi duke u theksuar obligimin e shkollave për veprimtarinë arsimore-edukative dhe kujdesin për rritjen dhe zhvillimin e drejtë të fëmijëve dhe çdo përpjekje për veprim politik dënohet me ligj. Ai u bëri thirrje këshillave shkollorë, kryetarët e komunave, Inspektorati Arsimor Shtetëror dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës, secili në suazat e kompetencave të veta të ndërmarrë masat përkatëse kundrejt personave të cilët bëjnë agjitacion apo lejojnë që në shkolla të bëhet agjitacion. Avokati i Popullit, Ixhet Memeti me iniciativë personale ka hapur procedurë kundër drejtorit të gjimnazit të Prilepit “Mirçe Acev”, kurse mban procedurë edhe për drejtoreshën e gjimnazit shkupjan “Josip Broz Tito”, me fletëparaqitje nga prindi, pasi ajo në fillit të muajit me shpallje i ka urdhëruar në orën 15 atë ditë të dalin para shkollës që të xhirohen nga media të afërta me pushtetin dhe kështu të tregohet se demok po shkojnë në protestë kundër dygjuhësisë.<sup>27</sup>

## Raporti i Avokatit të Popullit mbi gjendjen me të drejtat dhe liritë e njeriut në vitin 2016

Më 30.03. 2017 Avokati i Popullit, Ixhet Memeti, ka mbajtur konferencë për shtyp në të cilën e ka prezantuar Raportin e Avokatit të Popullit mbi gjendjen me liritë dhe të drejtat e njeriut në vitin 2016.<sup>28</sup> Në fjalimin hyrës ai theksoi keqardhjen e vet për stagnimin, kurse në disa fusha edhe përkeqësimin e gjendjes me të drejtat dhe liritë e njeriut që të dëshmojë zmadhimin e konstatimeve të shkeljeve prej katër për qind. Memeti i dëshmoi edhe institucionet e politizuara dhe jofunksionale të cilat kanë zbatuar

<sup>25</sup> <http://sdk.mk/index.php/makedonija/narodniot-pravobranitel-istrazuva-politichka-zloupotreba-na-detsa-vo-shkolite/>

<sup>26</sup> <http://mhc.org.mk/announcements/547#.WOI7zPI97IU>

<sup>27</sup> <http://sdk.mk/index.php/makedonija/narodniot-pravobranitel-otvori-postapka-protiv-direktorot-na-prilepskata-gimnazija-za-politichko-agitirane-pred-uchenitsite/>

<sup>28</sup> <http://ombudsman.mk/upload/Godisni%20izvestai/GI-2016/GI-2016.pdf>





edhe agjenda partiake, veprimin joprofesional dhe brutal policor, përdorimin jashtë mase të fuqisë së policisë së burgut përkundrejt personave të burgosur dhe mungesën e mbrojtjes sistematike shëndetësore në institucionet ndëshkimore përmirësuese, mangësitë në sistemin e pensionit me pasoja të dëmshme për të siguruarit, mjetet e pasiguruara për pagim të të drejtave të mbrojtjes sociale, shkelja e të drejtës së punësimit të personave me paafësi për punë, depërtimin e paligjshëm të migrantëve, përcaktimin jashtëligjor dhe pagesën e taksës së radiodifuzionit dhe ujit, tatimin e jashtëligjshëm ndaj qytetarëve, si dhe mungesën e profesionalizmit në punën e organeve zgjedhore. Në raportin e këtij viti, Avokati i Popullit dhe njësitë rajonale kanë vepruar sipas 4.718 rasteve, prej të cilave në periudhën e raportit janë pranuar 3.775 ankesa, kurse 37 janë hapur me iniciativë personale.<sup>29</sup>

### **Krim nga urrejtja**

Vazhduan incidentet që mund të karakterizohen si vepra nga urrejtja. Gjatë këtij muaji, Komiteti i Helsinkit ka regjistruar 12 incidente të tilla.<sup>30</sup> Në gjysmën e incidenteve si kryerës dhe viktima shfaqen përsëri të rinjtë dhe personat e mitur të cilët sulmohen midis tyre në autobusë dhe në afërsi të stacioneve të autobusëve. Mandej, 3 incidente lidhen me goditjen me gurë të shtabeve të partive politike në Shkup (2 të LSDM-së dhe 1 i VMRO-DPMNE-së), kurse në Prilep është sulmuar një aktiviste e LSDM-së. Një incident jashtëzakonisht serioz që mund të shkaktonte urrejtje etnike ishte sulmi me kokteje molotov mbi Muzeun e Alfabetit Shqiptar në Manastir.<sup>31</sup> Personat kanë dashur t'i vënë zjarrin objektit, por nuk kanë arritur, kurse janë thyer dritaret. Nga fundi i muajit, MPB-ja shpalli se në PTHP Manastir është dorëzuar fletëparaqitje penale kundër katër personave në moshë nga 16-17 vjet prej të cilëve tre persona janë nga Manastiri kurse një person nga Demir Hisari, për shkak të ekzistimit të bazës së dyshimit se kanë kryer vepër penale "Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm" në mënyrë të tillë duke përgatitur 4 "kokteje molotov" dhe janë drejtuar kah Muzeut me qëllim që t'ia vënë zjarrin objektit. Ky sulm mbi Muzeun është i pesti me radhë në katër vitet e fundit.

<sup>29</sup> <http://ombudsman.mk/upload/documents/2017/Pres%20GI-2016/Press%202016-Mk.pdf>

<sup>30</sup> <http://www.zlostorstvaodomraza.mk>

<sup>31</sup> <http://www.zlostorstvaodomraza.com/reports/view/395>

